

Bashkëpunimi në kuadër të projektit IPA



Ka dy vjet që Bashkia Kamëz, me krijimin e Drejtorisë së re Koordinim-Zhvillimit, ka marrë pjesë aktive në aplikimet në programin e Këshillit Evropian për asistencë teknike e financiare për vendet e Evropës Juglindore, i njohur si programi IPA. Ky program, siç dihet, ka në filozofinë e vet dhënien e asistencës nëpërmjet bashkëpunimit në rrjet të vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve të tjera që bëjnë pjesë në Bashkimin Evropian. Në vitin e parë, pra 2009, bashkia mori mesazhe nga strukturat drejtuese të projektit se aplikimi i saj në projekt IPA 1 dhe 2 ishte vlerësuar për aftësitë profesionale në prezantimin e një informacioni të plotë dhe përmbushjen e kriterëve, në përputhje me kërkesat e programit. Si rrjedhojë, bashkia në atë vit u pranua e u afirmua si e përfshirë në rrjetin e aplikimeve dhe bashkëpunimeve të programit IPA 1 dhe 2. Kjo bëri që në vitin 2010, bashkia të kishte akses më të madh në këtë program, duke aplikuar në dy projekte, për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe futjen e metodave rinovuese, veçanërisht në fushën e energjisë. Të dyja projektet e kaluan fazën e parë të përzgjedhjes, si rrjedhojë e plotësimit të kërkesave të projektit, në pikëpamje të parashtrimit të nevojave, qëllimit, objektivave dhe instrumenteve ndërhyrëse për arritjen e tyre. Po kështu, bashkia iu përgjigj në koherencë dhe saktësisht edhe kërkesave të parashtruara nga programi për fazën e dytë, kërkesa që kishin të bënin me përmbushjen e procedurave ligjore, administrative dhe financiare, në kuadër të fazës së tretë, që është ajo miratuese dhe implementuese.



Dhe tashmë u arrit sukcesi, strukturat e IPA-s miratuan projektin e menaxhimit të mbetjeve urbane në vlerën 300 mijë euro për Kamzën. Në fazën e vlerësimit, të koordinimit dhe avancimit drejt miratimit të projekteve në programin IPA 1, 2, përfaqësuesit e bashkisë kanë marrë pjesë në takime të organizuara nga Këshilli i Evropës nëpërmjet Ministrisë së Integrimit të Shqipërisë, ku kanë shkëmbyer informacion dhe qartësuar më tej hapat finalizues për projektet. Gjithashtu, bashkia ka tashmë të arkivuar e të depozituar në rrugë elektronike dhe të printuar gjithë

dokumentacionin e dërguar nga strukturat e KE-së për IPA-n, për procedurat dhe kërkesat e plotësuara, hap pas hapi, në lidhje me fazat e ecjes së projekteve, ku ajo është përfshirë. Si pjesëmarrëse aktive, aplikuese dhe e përzgjedhur në programin IPA 1, 2, Bashkia Kamëz në shtator u ftua të merrte pjesë edhe në konsultën e organizuar nga KE-ja dhe Ministria e Integrimit për programin IPA 3 dhe 4, ku drejtoria, mbështetur në eksperiencën e deritanishme, dha kontributin e vet në diskutimet e zhvilluara në grupet e debatit, sipas tematikës. Asaj iu vu në dispozicion edhe materiali bazë për programin IPA 3 dhe 4, si edhe konkluzionet finale të arritura nga konsulta për këtë program.

Duke qenë se Bashkia Kamëz tashmë ka konfirmuar pjesëmarrjen dhe rolin e vet aktiv në këtë program të rëndësishëm të Këshillit Evropian, është ftuar të marrë pjesë edhe në seminare që kanë trajtuar këtë temë nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe qarku i Tiranës, mbështetur nga fondacioni gjerman “Sejdel” dhe shoqata holandeze SNV, ku ajo ka prezantuar edhe eksperiencën e vet për pjesëmarrjen në programin IPA.